VENDIM
Nr. 503, datë 27.7.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, VORË DHE SHIJAK

(ndryshuar me VKM nr. 780, datë 12.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 245 913 398 (dyqind e dyzet e pesë milionë e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë, pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para sipas aktekspertizave të thelluara në bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës, në masën 72 409 932 (shtatëdhjetë e dy milionë e katërqind e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Vorë, në masën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Shijak, në masën 73 503 466 (shtatëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Shfuqizuar.

3. Efekti financiar për bashkitë Vorë dhe Shijak, sipas shkronjave "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi i rindërtimit i miratuar për vitin 2022 dhe i transferohet bashkive Vorë dhe Shijak në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj